



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 958 / Prot.

Vlorë më, 19.03.2025

VENDIM

Nr. 26, datë 19.03.2025

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "BACHELOR NË
INFERMIERI E PËRGJITHSHME"**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë*" si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kurrikulave dhe Statistikave me nr. 951 datë 19.03.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Programit të studimit "Bachelor në Infermieri e Përgjithshme" në gjuhën shqipe dhe angleze" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shëndetit dhe Zëvendësrektori Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**RREGULLORJA E PROGRAMIT MËSIMOR TË CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE:**

BACHELOR NË INFERMIERI TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore e rregullores

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjin Nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe Statutit e Rregullores së Universitetit 'Ismail Qemali' të Vlorës dhe mbështetur në "to".

Neni 2

Emërtimi dhe statusi i programit

Programi mësimor Bachelor në Infermieri të Përgjithshme është program i ciklit të parë të studimeve, i ofruar nga Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit në Universitetin 'Ismail Qemali' Vlorë, miratuar nga MAS në vitin 1994: VKM Nr.105, dt. 28-02-1994 dhe riformatuar me Urdhër Nr.398 të MAS, dt.10-08-2011.

Ky program mësimor është i organizuar në tre vite akademike (6 semestra) dhe në përfundim të tij studentët grumbullojnë minimalisht 180 ECTS dhe marrin diplomën: Bcs në Infermieri të Përgjithshme.

Neni 3

Objektivat formuese të programit të studimit Bcs në Infermieri të Përgjithshme

Programi mësimor 'Bachelor në Infermieri të Përgjithshme' formon Infermierë me formim të përgjithshëm, në përputhje me misionin madhor të FSH, që është të rrisë standartet e shëndetit komunitar nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe komunikimit.

Ky program mësimor synon formimin profesional të infermierëve që ata të jenë plotësisht kompetentë për të përmbushur nevojat që parashtron profesioni i tyre, në një mjedis dinamik të kujdesit shëndetësor komunitar. Spektri i kompetencave infermirore po vjen duke u zgjeruar vazhdimisht dhe programet që ne ofrojmë synojnë formimin e specialistëve të infermieristikës për të sotmen e për të ardhmen.

Objektivat e këtij programi përfshijnë:

- Plane bashkëkohore të asistencës infermirore në praktikën infermirore.
- Të menduarit kritik në gjykimet dhe vendim-marrjet profesionale.
- Të mësuarit e bazuar në problem.
- Komunikimin efektiv me të tjerët.
- Kontribuimin në rritjen e kapaciteteve shëndetësore komunitare.
- Zhvillimin e rolit të infermieres profesionale në procesin e kujdesit shëndetësor si koordinatorë, mbrojtëse dhe pjesë integrale e profesionit infermior.

Gjatë gjithë periudhës së formimit studentit do t'i duhet të zhvillojë aftësitë e nevojshme për të kontribuar në dhënien e përkujdesjeve cilësore, me qëllim që të ndikojë në përmirësimin e shëndetit të popullsisë dhe të ushtrojë profesionin në gjirin e një ekipi shumëdisiplinor në sektorët sanitarë e socialë.

Neni 4

Lista e disiplinave mësimore, të ndara në module dhe veprimtari të tjera formuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Plani i ri i riorganizuar Bachelor në Infermieri e Përgjithshme 2025-2028

Ndarja e moduleve sipas veprimtarive formuese				
		Kodi	Lënda	Kreditet
Lëndë bazë: A	1.	INF 102	Biologji e përgjithshme dhe Gjenetikë	4
	2.	INF 103	Biofizikë	3
	3.	INF 104	Kimi e përgjithshme	3
	4.	INF 101	Biokimi mjekësore	4
	5.	INF 130	Anatomi normale dhe patologjike (v)	9
	6.	INF 150	Fiziologji normale dhe patologjike	6
Totali A				29
Lëndë karakterizuese: B	7.	INF 160	Bazat e Kujdesit Infermior (v)	8
	8.	INF 271	Kujdesi Infermior në Sëmundjet e Adultit I	5
	9.	INF 272	Kujdesi Infermior në Sëmundjet e Adultit II	5
	10.	INF 330	Kujdesi Infermior në Sëmundjet e Adultit III	6
	11.	INF 331	Kujdesi Infermior në Sëmundjet e Adultit IV	6
	12.	INF 220	Sëmundje të adultit I (v)	10
	13.	INF 350	Sëmundje të adultit II (v)	11
	14.	INF 221	Kirurgji e përgjithshme	4
	15.	INF 320	Kirurgji e specializuar	4
	16.	INF 210	Pediatri	6
	17.	INF 280	Kujdesi Infermior për Fëmijën	3
	18.	INF 240	OBS dhe Shëndet riprodhues	6
	19.	INF 281	Kujdesi Infermior për Nënë	3
	20.	INF 310	Shëndet mendor	3
	21.	INF 311	Kujdesi Infermior në Psikiatri	3
	22.	INF 222	Infermieri e aplikuar në Geriatri	5
	23.	INF 223	Kujdes palativ	3
	24.	INF 241	Kujdesi infermior në Urgjenca shëndetësore dhe Emergjenca	4
	25.	INF 373	Ushqyerja dhe Dietoterapia	4
Totali B				99



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Lëndë ndërdisiplinore / integruese: C	26.	INF 180	Shëndet Publik dhe Edukim shëndetësor	4
	27.	INF 181	Bioetikë dhe Aftësitë e komunikimit në infermieri	3
	28.	INF 182	Legjislacioni i profesionit të infermierit	2
	29.	INF 183	Higjena dhe kontrolli i infeksionit	2
	30.	INF 184	Metodologjia e Kërkimit Shkencor	3
	31.	INF 230	Bazat e Farmakologjisë	5
	32.	INF 231	Mikrobiologji	4
	33.	INF 250	Parime bazë të menaxhimit shëndetësor	2
		INF 251	Parime dhe metoda të mësimdhënies	
		INF 252	Shkrim akademik	
	34.	INF 253	Aspekte sociale të infermierisë	2
		INF 254	Psikologji bazë dhe klinike	
		INF 255	Shëndet profesional dhe siguria në punë	
Totali C				27
Lëndë plotësuese D	35.	INF 110	Terminologji mjekësore	3
	36.	ENGI 130	Anglisht	3
		ENGI 131	Anglisht profesionale	
		GERI 130	Gjermanisht	
		GERI 131	Gjermanisht profesionale	
		ITAI 130	Italisht	
		ITAI 131	Italisht profesionale	
	37.	INF 178	Statistikë mjekësore	3
		CSI 130	TIK dhe Digjitalizim	
	38.	INF 300	Praktika profesionale	10
Totali D				19
Detyrimet përmbyllëse: E 6 kredite	39.	INF 399	Provim final / Temë Diplome	6
Totali E				6
TOTALI				180

Neni 5

Plani mësimor i programit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme për të tre vitet e studimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Neni 6

Objektivat formues specifike të çdo disipline apo veprimtaritë e tjera formuese

**KATALOGU I PROGRAMIT MËSIMOR
BACHELOR NË INFERMIERI TË PËRGJITHSHME**

INF 102 Biologji e përgjithshme dhe Gjenetikë (4 ETC)

Bazat e Biologjisë së përgjithshme dhe Gjenetikës, ka si objektiv të pajisë studentin me disa nga konceptet bazë të teorisë qelizore dhe të fiziologjisë e biokimisë së qelizës. Qëllimi i lëndës është konceptimi i modeleve dhe mekanizmave biokimikë të cilat bëjnë të mundur realizimin e proceseve fiziologjike qelizore si fotosinteza, frymëmarja, cikli qelizor, riprodhimi dhe zhvillimi si dhe tejçimi i tipareve nëpërmjet gjenetikës.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të përcaktojnë komponentët kryesorë inorganikë dhe organikë të organizmit.
- ☞ Të diferencojnë një organizëm eukariot nga një prokariot dhe një virus.
- ☞ Të njohin rregullat dhe ligjet e gjenetikës mendeliane.
- ☞ Të bëjnë dallimin midis organizmave eukariotë dhe prokariotë.
- ☞ Të njohin me simptomat dhe kuadrin klinik të sëmundjeve gjenetike.
- ☞ Të njohin mënyrën e trashëgimisë së sëmundjeve gjenetike humane.

INF 103 Biofizikë (3 ECTS)

Kursi i Biofizikës ka si qëllim të njohë studentët me ligjet e fizikës të aplikueshme në sistemet biologjike si dhe në infermieri. Një vemendje e veçantë u kushtohet dukurive të ndryshme që ndodhin në sistemet biologjike siç janë dukuritë e transportit biologjik të lëndëve të ndryshme në organizëm, të procesit të transporteve të gazeve, etj. Gjithashtu kjo lëndë i pajisë studentët me njohuri që kanë të bëjnë me disa nga dukuritë elektrike biomjekësore që ndodhin në organizmin e njeriut.

Objektivat e modulit:

- ☞ Pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme sesi funksionon një sistem biologjik nga pikëpamja fizike;
- ☞ Pajisja e studentëve me njohuritë bazë për dukuritë kryesore që ndodhin në sistemet biologjike; transportit të lëndëve dhe frymëmarrjes.
- ☞ Njohja me disa nga ligjësitë e funksionimit të sistemit kardio qarkullues dhe të organeve të dëgjimit;
- ☞ Njohja me dukuritë elektrike biomjekësore, procesin e të dëgjuarit dhe të të parit.

INF 104 Kimi e përgjithshme (3 ETC)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Gjatë këtij kursi studentët do të njihen me: parimet bazë të teorisë atomike e molekulare; stekiometrinë; përshkrimin e strukturës elektronike të atomit; njohjen e vetive të elementëve kimikë në sistemin periodik; organizimin e atomeve në jone dhe molekula, lidhjet kimike; emërtimin e komponimeve kimike, barazimin e reaksioneve kimikë dhe zgjidhjen e problemave të ndryshme; tretërirat dhe vetitë e tyre; gazet dhe vetitë e tyre; ndryshimet energjitike në reaksion

Objektivat e modulit:

Në përfundim të këtij kursi synohet:

- ☞ njohja e studentëve me konceptet bazë mbi lëndën, elementet dhe substancat kimike,
- ☞ zgjidhjen e ushtrimeve dhe problemave në kimi, interpretimin e të dhënave,
- ☞ shpjegimin e proceseve të ndryshme kimike

INF 101 Biokimi mjekësore (4 ETC)

Lënda Biokimi Mjekësore trajton proceset kimike dhe molekulare që ndodhin në organizmin e njeriut. Ajo fokusohet në përbërësit kryesorë të jetës, si proteinat, karbohidratet, lipidet, acidet nukleike, vitaminat si dhe në funksionet e tyre biologjike. Studentët mësojnë mekanizmat e reaksioneve biokimike, rolin e enzimave, metabolizmin dhe proceset energjetike, frymëmarrjen dhe fotosintezën. Ajo studion mënyrën e funksionimit të organizmit në nivel molekular, ndryshimet biokimike dhe sëmundjet që lidhin proceset biokimike me patologjitë dhe sëmundjet metabolike, duke shpjeguar se si ndryshimet në molekula dhe rrugë metabolike ndikojnë në shëndetin e organizmit

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të identifikojnë dhe përshkruajnë strukturën dhe funksionin e molekulave kryesore biologjike, si proteinat, karbohidratet, lipidet dhe acidet nukleike.
- ☞ Të shpjegojnë dhe analizojnë mekanizmat enzimatikë, përfshirë rregullimin dhe rolin e enzimave në proceset qelizore
- ☞ Të kuptojnë dhe interpretojnë ciklet metabolike, si glikoliza, cikli i Krebsit dhe fosforilimi oksidativ, duke i lidhur ato me prodhimin e energjisë në organizma.
- ☞ Të aplikojnë aftësi eksperimentale në laborator, duke përdorur teknika për matjen dhe analizën e reaksioneve biokimike.
- ☞ Të lidhin proceset biokimike me patologjitë dhe sëmundjet metabolike, duke shpjeguar se si ndryshimet në molekula dhe rrugë metabolike ndikojnë në shëndetin e organizmit.

INF 130 Anatomia normale dhe patologjike (v) (9 ETC)

Anatomia është shkenca që përshkruan formën, strukturën e organeve, aparateve dhe sistemeve të trupit të njeriut. Përfshin studimin e kockave, muskujve, organeve, indeve, në semestrin e parë dhe në semestrin e dytë vazhdon me sistemin nervor, arteriet, venat dhe kapilarët, arteriet dhe venat e qarkullimit sistematik, arteriet dhe venat e qarkullimit pulmonar dhe ndërtimin e tyre. Anatomia e njeriut ofron informacion rreth vendndodhjes dhe ndërtimit të pjesëve të ndryshme të trupit si dhe përvetësimin e terminologjisë anatomike.

Objektivat e modulit:

Lënda ofron bazën për të kuptuar gjeneralitetet morfologjike të trupit të njeriut.

Studentët fitojnë njohuri për korrelacionet morfo-funksionale midis sistemeve të ndryshme të trupit.

Imazhet shpjegohen në leksione me qëllim memorizimin dhe pamjen tredimensionale të kockave, muskujve dhe organeve, organizimin strukturor të sistemit të qarkullimit të gjakut, vendndodhjet e arterieve dhe venave, marrëdhëniet topografike, korrelacionet morfo-funksionale. Studimi i sistemit nervor synon t'u sigurojë studenteve njohuri mbi funksionimin normal të tij dhe marrëdhëniet me pjesët e ndryshme të trupit. Studentët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

fitojnë aftësi për emërtimin, gjetjen, njohjen dhe ndërtimin e aparateve dhe sistemeve të trupit të njeriut. Studentët njihen me konceptet bazë se cilët janë shkaktarët e sëmundjeve dhe organeve të dëmtuara.

INF 150 Fiziologji normale dhe patologjike (6 ETC)

Fiziologjia normale është një lëndë paraklinike që i pajis studentët me njohuritë e nevojshme për funksionimin normal të organizmit të njeriut, duke filluar nga funksionet e qelizës dhe duke vazhduar me funksionet e çdo sistemi organesh në veçanti.

Ndërsa fiziologjia patologjike paralelisht studion funksionet e çrregulluara në organizëm, shkaqet e tyre dhe mekanizmat e përfshirë në to si dhe ligjshmërinë e fillimit, ecurisë dhe përfundimit të sëmundjes, mënyrën e përshtatjes dhe përgjigjes së organizmit të sëmurë.

Objektivat e lëndës:

- ☞ Njohja me funksionet në nivel qelizor dhe indor.
- ☞ Njohja me funksionet e cdo organi të organizmit të njeriut.
- ☞ Njohja me funksionet dhe kontrollin e cdo sistemi të organizmit të njeriut
- ☞ Njohja me mënyrën e funksionimit të organizmit njerëzor si një i tërë.
- ☞ Njohja me funksionet e çrregulluara të organizmit, shkaqet e tyre dhe mekanizmat kompensatore të organizmit

INF 160 Bazat e Kujdesit Infermior (v) (8 ETC)

Lënda "Bazat e Kujdesit Infermior" ofron njohuritë themelore mbi kujdesin infermior, duke përfshirë procesin infermior, komunikimin, edukimin e pacientit dhe sigurinë në praktikë. Studentët do të mësojnë parimet e vlerësimit dhe menaxhimit të nevojave bazë të pacientëve, kontrollin e infeksioneve, administrimin e medikamenteve dhe kujdesin gjatë gjithë ciklit të jetës. Përmes kombinimit të teorisë dhe praktikës, lënda synon të zhvillojë aftësitë e tyre për një kujdes cilësor dhe të sigurt ndaj pacientëve.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Parimet themelore të kujdesit infermior, duke përfshirë procesin infermior (vlerësimi, diagnoza, planifikimi, zbatimi dhe vlerësimi i kujdesit).
- ☞ Parimet e komunikimit dhe edukimit shëndetësor për të ndërvepruar në mënyrë efektive me pacientët dhe ekipin shëndetësor.
- ☞ Masat për sigurinë dhe parandalimin e infeksioneve, duke përfshirë kontrollin e higjienës dhe përdorimin e teknikave aseptike.
- ☞ Administrimin e medikamenteve në mënyrë të sigurt dhe bazuar në udhëzimet profesionale.
- ☞ Kujdesin gjatë gjithë ciklit të jetës, duke njohur nevojat e ndryshme të pacientëve sipas moshës dhe gjendjes shëndetësore.
- ☞ Menaxhimin e situatave të veçanta, si humbja, stresi dhe përballja me sëmundjet kronike.
- ☞ Parimet e vlerësimit të shenjave jetësore, balancës së lëngjeve dhe elektroliteve, ushqyerjes dhe nevojave bazë të pacientëve.

INF 271 Kujdesi Infermior në Sëmundjet e Adultit I (5 ETC)

Kjo lende përfshin tre kapituj: Kujdesin infermior në sëmundjet e adultit në Okulistike, Kujdesin infermior në sëmundjet e adultit në Otorinolaringologji, Kujdesin infermior në sëmundjet e adultit në Dermatologji.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Okulistika është shkencë që studion ndërtimin dhe funksionimin e syrit. Studenti në këtë specialitet do të marrë informacion mbi anatominë, fiziologjinë, fizipatologjitë e syrit dhe kujdesin infermieror për shumë sëmundje të syve.

Otorinolaringologjia (ORL) është shkencë që studion veshin, fytin, hundën dhe gypin trakeobronkial. Në këtë specialitet student merr informacion mbi anatominë e veshit, sëmundjet më të shpeshta në ORL dhe asistencën infermiere.

Dermatologjia është shkencë në të cilën studentët të marrin informacion mbi strukturën, funksionin dhe kujdesin e lëkurës normale, llojet e përgjithshme të lëzimeve të lëkurës dhe parimet bazë të trajtimit dhe kujdesin infermieror.

Objektivat e modulit:

- ☞ Do të njihen me objektin e studimit të shkencave më të bukura të Mjekësisë: Okulistikë/ ORL, Dermatologji
- ☞ Do të kenë njohuri të mjaftueshme për anatominë, fiziologjinë dhe fizipatologjitë e syrit, veshit, hundës, laringut, faringut, lëkurës si dhe të kujdesjeve infermiere të adultit.
- ☞ Do të mund të realizojnë kujdesje infermiere për shumë sëmundje që studiojnë këto shkencë. Do të dinë të realizojnë përkujdesjet infermiere në rastet emergjente të adultit.

INF 272 Kujdesi Infermieror në Sëmundjet e Adultit II (5 ETC)

Në këto lende studenti pasi ka marrë njohuritë përkatëse për patologjitë që prekin adultin në sëmundje të Brendshme I, Neurologji, përfitimet në fushën e kujdesit infermieror për të përballuar me sukses çdo situatë që i takon kësaj kujdesjeje.

Merr njohuritë përkatëse për diagnozat infermiere si dhe protokollet e ndryshme të përkujdesjeve infermiere.

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me kujdesin infermieror në patologjitë kryesore që prekin adultin.
- ☞ Paraqitja e vlerësimit infermieror të pacientit.
- ☞ Njohja me protokollet e përkujdesjeve infermiere si dhe hartimin e diagnozave infermiere.

INF 330 Kujdesi Infermieror në Sëmundjet e Adultit III (6 ETC)

Në këto lende studenti pasi ka marrë njohuritë përkatëse për patologjitë që prekin adultin në sëmundje të Brendshme II, përfitimet në fushën e kujdesit infermieror për të përballuar me sukses çdo situatë që i takon kësaj kujdesjeje.

Merr njohuritë përkatëse për diagnozat infermiere si dhe protokollet e ndryshme të përkujdesjeve infermiere.

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me kujdesin infermieror në patologjitë kryesore në traumatologji, fizioterapi dhe reanimacion
- ☞ Paraqitja e vlerësimit infermieror të pacientit.
- ☞ Njohja me protokollet e përkujdesjeve infermiere si dhe hartimin e diagnozave infermiere.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

INF 331 Kujdesi Infermior në Sëmundjet e Adultit IV (6 ETC)

Në këtë lëndë studenti pasi ka marrë njohuritë përkatëse për patologjitë që prekin adultin në Sëmundje të Brendshme, Nefrologji, Gastrohepatologji, Hematologji dhe Endokrinologji përgatitet në fushën e kujdesit infermior për të përballuar me sukses çdo situatë që i takon kësaj kujdesjeje. Merr njohuritë përkatëse për diagnozat infermiore, planet e kujdesit, ndërhyrjet si dhe protokollet e ndryshme të përkujdesjeve infermiore.

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me kujdesin infermior në patologjitë kryesore që prekin adultin.
- ☞ Paraqitja e vlerësimit infermior të pacientit.
- ☞ Njohja me protokollet e përkujdesjeve infermiore si dhe hartimin e diagnozave infermiore.

INF 220 Sëmundje të adultit I (v) (10 ETC)

Në këtë modul përfshihen patologjitë kryesore të sistemit kardio-vaskular dhe hematologjik. Gjatë kësaj lënde studentët do të mësojnë të njohin klinikisht sëmundjet më të shpeshta të këtyre aparateve, të adresojnë menaxhimin e tyre dhe të ndërtojnë promocionin shëndetësor për to.

Objektivat e modulit:

- ☞ Në lëndën "Sëmundjet e Adultit I" studentët do të marrin njohuri të mjaftueshme mbi sëmundjet e aparatit kardio-vaskular dhe sëmundjet hematologjike.
- ☞ Studentët do të marrin edhe njohuri të mjaftueshme mbi kujdesin infermior, asistencën ndaj të sëmurëve me patologji kardio-vaskulare dhe hematologjike.
- ☞ Njëkohësisht në këtë program përfshihen edhe njohuritë për të gjitha procedurat dhe ekzaminimet që aplikohen në këta të sëmurë.

INF 350 Sëmundje të adultit II (v) (11 ETC)

Në këtë modul përfshihen patologjitë kryesore të sistemit urinar dhe do të njihen me disa koncepte të reja të sëmundjeve onkologjike. Gjatë kësaj lënde studentët do të mësojnë të njohin klinikisht sëmundjet më të shpeshta të sistemit renal dhe disa nga patologjitë tumorale më të shpeshta, të adresojnë menaxhimin e tyre dhe të ndërtojnë promocionin shëndetësor për to.

Objektivat e modulit:

- ☞ Në lëndën "Sëmundjet e Adultit II-b" studentët do të marrin njohuri të mjaftueshme mbi sëmundjet e aparatit urinar dhe sëmundjet onkologjike.
- ☞ Studentët do të marrin edhe njohuri të mjaftueshme mbi kujdesin infermior, asistencën ndaj të sëmurëve me patologji të pulmoneve dhe ato të aparatit osteo-artikular.
- ☞ Njëkohësisht në këtë program përfshihen edhe njohuritë për të gjitha procedurat dhe ekzaminimet që aplikohen në këta të sëmurë.

INF 221 Kirurgji e përgjithshme (4 ETC)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Në këtë lende studiohet organizmi i punës në kirurgjinë ambulatorë dhe spitalore, parimet kryesore të asepsisë dhe antisepsisë, praktikat e perpunimit të plagëve, mjetet dhe instrumentet kirurgjikale, grupet e gjakut, Sëmundjet e ndryshme kirurgjikale - që janë shumë të rëndësishme për përgatitjen e infermierëve të ardhshëm me profesionalitet dhe edukatë mjekësore për të trajtuar pacientë me probleme kirurgjikale.

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me organizimin e punës në kirurgji dhe masat mbrojtëse në të.
- ☞ Studimi i metodave specifike dhe jo specifike për diagnozën e pacientëve kirurgjikal.
- ☞ Njohje me patologjitë më të shpeshta kirurgjikale dhe rolin e infermierit në diagnostikimin dhe trajtimin e këtyre patologjive.

INF 320 Kirurgji e specializuar (4 ETC)

Në këtë lende studiohet organizmi i punës në kirurgjinë ambulatorë dhe spitalore, parimet kryesore të asepsisë dhe antisepsisë, praktikat e perpunimit të plagëve, mjetet dhe instrumentet kirurgjikale, grupet e gjakut, sëmundjet e ndryshme kirurgjikale - që janë shumë të rëndësishme për përgatitjen e infermierëve të ardhshëm me profesionalitet dhe edukatë mjekësore për të trajtuar pacientë me probleme kirurgjikale.

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me organizimin e punës në kirurgji dhe masat mbrojtëse në të.
- ☞ Studimi i metodave specifike dhe jo specifike për diagnozën e pacientëve kirurgjikal.
- ☞ Njohje me patologjitë më të shpeshta kirurgjikale dhe rolin e infermierit në diagnostikimin dhe trajtimin e këtyre patologjive.

INF 210 Pediatri (6 ETC)

Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri profesionale në fushën e perinatologjisë dhe patologjive pediatrike. Perinatologjia studion kujdesin shëndetsor për fëmijën e porsalindur dhe trajtimin e problemeve që mund të shfaqen gjatë periudhës neonatale. Gjithashtu studentët do të mësohen të njohin dhe të trajtojnë sëmundjet më të shpeshta të moshës fëmijënore.

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me faktorët riskantë të shëndetit të fëmijës gjatë periudhës perinatale.
- ☞ Paraqitja e vlerësimit klinik të neonatit.
- ☞ Njohja me patologjitë e neonatit dhe të fëmijës sipas trakteve dhe sistemeve, si dhe me strategjitë e menaxhimit të tyre.

INF 280 Kujdesi Infermior për Fëmijën (3 ETC)

Kjo lëndë fokusohet në ndihmën dhe mbështetje për fëmijët që vuajnë nga çrregullime të ndryshme shëndetësore si ato të sistemit respirator, kardiak, nervor, dhe të tjerë. Studentët Infermier- Mami duhet të jenë të aftë të ofrojnë kujdes të specializuar dhe të ndërveprojnë ngushtësisht me familjet e fëmijëve për të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

siguruar një trajtim efikas. Përveç kësaj, kjo lëndë përfshin edukimin dhe mbështetje emocionale për prindërit dhe fëmijët gjatë trajtimeve dhe rehabilitimeve të mundshme.

Objektivat e modurit:

- Të zhvillohen aftësitë për menaxhimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe gjendjeve shëndetësore të fëmijëve, duke përfshirë njohuri për sistemin respirator, kardiak, nervor dhe të tjera.
- Të përgatiten studentët për të ofruar kujdes të specializuar infermieror në trajtimin e sëmundjeve të zakonshme dhe të rënda tek fëmijët, duke siguruar mbështetje dhe menaxhim efikas të simptomave dhe komplikacioneve.
- Të zhvillohen aftësitë për komunikim dhe ndërveprim me prindërit dhe familjet, duke ofruar mbështetje emocionale dhe edukative gjatë trajtimit dhe periudhës së rikuperimit të fëmijës.
- Të forcohet kuptimi i rëndësisë së mbështetjes psiko-sociale për fëmijët dhe familjet që përballen me sfida të shëndetit, duke promovuar mirëqenien fizike dhe emocionale të fëmijëve.

INF 240 OBS dhe Shëndet riprodhues (6 ETC)

Eshte nje lende qe merret me studimin e fenomeneve dhe manifestimeve klinike ne organet e riprodhimit tek gruaja ne kushte normale apo patologjike dhe ka si synim pergatitjen e infermiereve-mami te afta per realizimin e teknikave obsterikale gjate procesit te lindjes, shtatzenise dhe trajtimit te patologjive te saj dhe semundjeve gjinekologjike.

Objektivat e modurit:

- ☞ Njohja me fiziologji e sistemit riprodhues dhe planifikimin e shtatzenise.
- ☞ Vleresimi i aktivitetit dhe lindjes normale, detyrat dhe metodat e aplikuara.
- ☞ Njohja me komplikacionet e shtatzenise, aktivitetit te lindjes dhe lindjes si dhe strategjitë e menaxhimit të tyre.
- ☞ Vleresimi i teknologjise se asistuar ne Shëndetin Riprodhues
- ☞ Vleresimi dhe strategjite e menaxhimit dhe edukimit te Shëndetit Seksual

INF 281 Kujdesi Infermieror për Nënë (3 ETC)

Lënda "**Kujdesi për Nënë**" fokusohet në ofrimin e kujdesit infermieror gjatë shtatzënisë, lindjes dhe periudhës paslindjes. Ajo trajton gjithashtu kujdesin për neonatin, duke përfshirë vlerësimin, parandalimin dhe trajtimin e problemeve shëndetësore. Studentët do të fitojnë aftësi praktike dhe njohuri për të mbështetur shëndetin e nënës dhe fëmijës në nivele të ndryshme të kujdesit. Kjo lëndë thekson rëndësinë e rolit të infermierit në promovimin e një kujdesi cilësor dhe gjithëpërfshirës për dy nga grupet më të ndjeshme të popullsisë.

Në përfundim të këtij kursi studentët do të kenë njohuri dhe aftësi mbi:

- ☞ **Përkujdesjet infermierore gjatë periudhës së shtatzënisë** – Studentët do të mësojnë të vlerësojnë dhe të monitorojnë shëndetin e gruas shtatzënë, të këshillojnë dhe të parandalojnë ndërlikimet e mundshme.
- ☞ **Përkujdesjet infermierore gjatë aktivitetit të lindjes** – Studentët do të fitojnë aftësi në mbështetjen e gruas gjatë lindjes, menaxhimin e dhimbjes, monitorimin e shenjave vitale dhe ndihmën në procesin e lindjes natyrale apo të asistuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

- ☞ **Përkujdesjet infermirore gjatë periudhës paslindjes** – Studentët do të mësojnë të ofrojnë kujdes të specializuar për nënën pas lindjes, të ndihmojnë në rikuperimin e saj dhe të promovojnë ushqyerjen me gji.
- ☞ **Përkujdesjet infermirore për neonatin**– Studentët do të zhvillojnë aftësi në kujdesin e përgjithshëm për neonatin , duke përfshirë monitorimin e rritjes dhe zhvillimit, identifikimin e shenjave të sëmundjeve dhe mbështetjen për familjen në procesin e kujdesit ndaj neonatit.

INF 310 Shëndet mendor (3 ETC)

Psikiatria dhe neurologjia bëjnë pjesë të neuroshkencave dhe janë lëndë klinike. Në këtë modul studentët do të marrin njohuri të përgjithshme mbi çrregullimet mendore dhe sëmundjet neurologjike. Ky modul gjithashtu i ndihmon studentët të marrin njohuri bazë mbi intervistën klinike, psikopatologjinë (shënjat dhe simptomat) dhe çrregullimet mendore më të zakonshme si spektri i çrregullimeve psikotike, çrregullimet e humorit, çrregullimet e personalitetit , çrregullimet e ankthit etj. të cilat kanë një prevalencë të lartë në ditët e sotme. Neurologjia është specialitet mjekësor i neuroshkencave që studion çrregullimet e sistemit nervor. Ajo merret me diagnostikimin dhe trajtimin e të gjitha kategorive të sëmundjeve që përfshijnë sistemin nervor qendror dhe periferik. Studentët do të marrin njohuri mbi llojet e egzaminimit neurologjik, sensibilitetin, refleksin, llojet e lëvizjeve dhe patologjitë e tyre, sëmundjet më të zakonshme të sistemit nervor qendror dhe periferik. Duke marrë njohuri mbi çrregullimet mendore dhe sëmundjet neurologjike studentët do të kuptojnë më mirë problematikat e shëndetit mendor të cilat sot janë shumë të zakonshme në të gjithë shoqërinë tonë .

Në përfundim të këtij kursi studentët do të kenë njohuri në drejtim të

- ☞ Njohja e psikopatologjisë.
- ☞ Njohja me çrregullimet mendore më të zakonshme
- ☞ Njohja me faktorët e riskut, diagnostikimin dhe format e trajtimit të tyre
- ☞ Njohja me egzaminimin neurologjik

Njohja me patologjitë e Sistemit Nervor Qendror dhe Sistemit Nervor periferik të cilat ndikojnë në shëndetin mendor.

INF 311 Kujdesi Infermior në Psikiatri (3 ETC)

Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri profesionale në fushën e kujdesit infermior në neurologji dhe në patologjitë psikiatrike. Shëndeti mendor studion kujdesin shëndetsor për personat të prekur nga sëmundje të SNQ dhe çrregullime të psikikës dhe trajtimin e problemeve që mund të shfaqen gjatë periudhave të ndryshme të jetës. Gjithashtu studentët do të mësohen të njohin dhe të trajtojnë sëmundjet më të shpeshta që dëmtojnë Shëndetin Mendor. Vlersimi infermior dhe diagnozat infermirore do të ndihmojnë studentin në ndërhyrjet infermirore.

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me faktorët riskantë të shëndetit mendor.
- ☞ Paraqitja e vlerësimit klinik të sëmundjeve mendore.
- ☞ Çrregullimet e psikikës sipas çrregullimit të konjicionit, si dhe me strategjitë e menaxhimit të tyre.

INF 222 Infermieri e aplikuar në Geriatri (5 ETC)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Infermiera e aplikuar në Geriatri është një lëndë e cila do të formojë studentët për dhënien e kujdesit infermieror në mënyrë profesionale dhe të kordinuar sipas protokolleve për ofrimin e shërbimit në moshat geriatrike. Infermiera e aplikuar në Geriatri ofron përkujdesjen për pacientët e moshuar dhe si infermierët mund të mbështesin shëndetin dhe mirëqenien e tyre si dhe do të ofrojnë njohuri themelore në lidhje me geriatri dhe parimet e kujdesit për të moshuarit, me një fokus të vecantë në fiziologjinë dhe psikologjinë e plakjes. Realizimi i praktikave mësimore në spital ka në fokus përvetësimin e shpejtë dhe të saktë të kujdesit infermieror në moshat geriatrike.

Objektivat e modulit:

- ☞ Përfitim të njohurive bazë në lidhje me ndihmën e parë dhe urgjencat kryesore mjekësore dhe ushqyerjen tek personat e moshuar .
- ☞ .Njohjen me faktorët riskantë të shëndetit të pacientit geriatrik me trauma.
- ☞ .Paraqitjen e vlerësimit klinik të personit të moshuar.

INF 223 Kujdes paliativ (3 ETC)

Kujdesi Paliativ është një lëndë e cila do të formojë studentët për dhënien e kujdesit infermieror në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ofrimin e shërbimit paliativ. Kujdesi Paliativ jepet në pacientët që janë prekur nga një sëmundje kronike, që përparon, për të cilën nuk ekzistojnë terapi ose, nëse ekzistojnë, janë të pamjaftueshme për të stabilizuar sëmundjen. Kujdesi paliativ përmirëson cilësinë e jetës së pacientëve dhe familjeve të tyre, të cilët përballen me problemet e lidhura me sëmundjet e pashërueshme, qofshin ato fizike, psikologjike. Realizimi i praktikave mësimore në spital ka në fokus përvetësimin e shpejtë dhe të saktë të kujdesit infermieror në pacientët Paliativ në përputhje me objektivat e lëndës.

Objektivat e modulit:

- ☞ Përvetësimi i Konceptit të Kujdesit Paliativ
- ☞ Identifikimi i Nevojave të Pacientëve
- ☞ Zhvillimi i Aftësive Praktike
- ☞ Përdorimi i Protokolleve të Kujdesit
- ☞ Komunikimi Efektiv
- ☞ Koordinimi i Kujdesit
- ☞ Vlerësimi i Cilësisë së Jetës
- ☞ Praktikë Etike në Kujdesin Paliativ

INF 241 Kujdesi infermieror në Urgjencë shëndetësore dhe Emergjencë (4 ETC)

Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuritë bazë dhe teknikat praktike për vlerësimin dhe menaxhimin e gjendjeve shëndetësore kërcënuese për jetën dhe të personave të dëmtuar. Realizimi i praktikave mësimore në spital ka në fokus përvetësimin e shpejtë dhe të saktë të kujdesit infermieror të urgjencës në përputhje me prioritetet.

Objektivat e modulit:

- ☞ Përfitimi i njohurive bazë në lidhje me urgjencën mjekësore dhe triazhimin.
- ☞ Të kuptuarit e rëndësisë së vlerësimit në kohë të pacientit dhe aftësimi për të njohur dhe praktikuar ndihmën jetësore bazë dhe të avancuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

- ☞ Aftësimi për të njohur dhe menaxhuar urgjencat kardiovaskulare, pulmonare, abdominale, urinare dhe mjedisore.
- ☞ Aftësimi për të njohur urgjencat nga intoksikacionet e ndryshme dhe indikacionet specifike të menaxhimit të tyre

INF 373 Ushqyerja dhe Dietoterapia (4 ETC)

Është një lëndë mbi mënyrën e të ushqyerit tek njeriu i shëndetshëm për një jetë sa me aktive si dhe dietoterapia në patologji të ndryshme, në mënyrë që të përgatitim infermierët e përgjithshëm për këshillimin e të ushqyerit në komunitet, dhe të aftë për përgatitjen në praktikën klinike të dietave ushqimore në përputhje me sëmundje të ndryshme.

Objektivat e modulit:

- ☞ Përfitimi i njohurive bazë në lidhje me parimet dhe konceptet e ushqyerjes së shëndetshme; duke orientuar pacientin drejt një shëndeti më të mirë nëpërmjet ndërgjegjësimit për ushqyerjen.
- ☞ Fokusimi i infermierëve në përmirësimin jo vetëm të statusit nutricional të pacientëve por edhe të gjendjes shëndetësore në tërësi.
- ☞ Të kuptuarit e rëndësisë së vlerësimit të ndikimit të sëmundjeve dhe ndërhyrjeve kirurgjikale në ushqyerje dhe përdorimin e përshtatshëm të dietoterapisë për ruajtjen e shëndetit.

INF 180 Shëndet Publik dhe Edukim shëndetësor (4 ETC)

Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri në fushën e Shëndetit Publik dhe edukimit shëndetësor. Shëndeti Publik: Ky modul studion adresimin e çështjeve të tilla si rritja apo ulja e sëmundjeve të ndryshme në periudha të ndryshme kohore, në popullata të ndryshme, si dhe në subjekte të ndryshme brenda të njëjtës popullatë.

Objektet e modulit:

- ☞ Njohja me konceptet bazë dhe problemet kryesore të shëndetit publik
- ☞ Të hartojë një model promocional shëndetësor.

INF 181 Bioetikë dhe Aftësitë e komunikimit në infermieri (3 ETC)

Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri lidhur me kuptimin bazë çështjeve etike në kujdesin shëndetësor, në mënyrë që t'i bëjë ata të aftë të analizojnë në mënyrë kritike ndërveprimin midis pacientit dhe profesionistit shëndetësor. Nëpërmjet kësaj lënde studenti arrin të thellojë kuptimin e tij për etikën në kujdes shëndetësor dhe komunikimin.

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me çështjet kryesore etike që hasen në kujesin shëndetësor
- ☞ Njohja me dimensionet ligjore dhe etike në komunikim dhe komunikimi në situata sfiduese.
- ☞ Përdorimi i teknikave të komunikimit dhe komunikimi efektiv në ekip për dhenien e zgjidhjeve në situata specifike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

- ☞ Të jetë në gjendje të përcaktojë bioetikën, bioetikën mjekësore, autonominë, bamirësinë dhe jo keqbërjen
- ☞ Të njohë fushat e bioetikës në praktikë dhe fushëveprimin e bioetikës
- ☞ Të njohë aspektet historike të bioetikës
- ☞ Të kuptojë vlerat e bioetikës mjekësore

INF 182 Legjislacioni i profesionit të infermierit (3 ETC)

Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri në fushën e legjislacionit shëndetësor, përfshirë aspektet etike dhe deontologjike të profesionit si dhe marrëdhënien pacient-infermier/personel shëndetësor.

Ky modul studion adresimin e çështjeve të lidhura me marrëdhënien infermier/personel shëndetësor-pacient.

Në lidhje me infermierin/personelin shëndetësor trajtohen aspekte të tilla si: figura etiko-profesionale e personelit shëndetësor, të drejtat e infermierit, sjellja e infermierit, ruajtja e sekretit profesional nga infermieri/personeli shëndetësor, gabimet mjekësore, etj.

Në lidhje me pacientin trajtohen aspekte të tilla si: konsenti, të drejtat e pacientit, aspekte etike-juridike lidhur me vdekjen, etj.

Gjithashtu, trajtohen problematikat etike-juridike të situatave të zakonshme si: refuzimi i mjekimit, teprimi terapeutik, mjekimet paliative, gjendja vegjetative, eutanazia, suicidi, të drejtat e të sëmurëve mendorë, etj, si dhe përgjegjësitë e personelit shëndetësor

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me aspektet etike-juridike çështjeve të lidhura me marrëdhënien infermier/personel shëndetësor- pacient.
- ☞ Njohja me aspektet etike-juridike të infermierit/personelit shëndetësor.
- ☞ Njohja me aspektet etike-juridike të pacientit.
- ☞ Njohja me problematikat etike-juridike të situatave të zakonshme
- ☞ Njohja me përgjegjësinë civile dhe penale të personelit shëndetësor

INF 183 Higjena dhe kontrolli i infeksionit (2 ETC)

Lënda "Higjienë dhe Kontrolli i Infeksioneve" synon të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi për të siguruar një mjedis të pastër dhe të sigurt në institucionet shëndetësore. Përmes kësaj lënde, studentët do të mësojnë mbi standardet e higjienës, parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve nozokomiale, si dhe zbatimin e protokolleve sanitare në praktikën e përditshme të kujdesit shëndetësor.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të kuptojnë rëndësinë e higjienës dhe parandalimit të infeksioneve në kujdesin shëndetësor.
- ☞ Të zbatojnë masat e higjienës dhe dezinfektimit në mjediset spitalore.
- ☞ Të monitorojnë cilësinë e ajrit, ujit dhe ushqimit në spitale për të parandaluar përhapjen e infeksioneve.
- ☞ Të përdorin metoda efektive të sterilizimit dhe teknikat aseptike në praktikën klinike.
- ☞ Të vlerësojnë dhe përmirësojnë higjienën personale të pacientëve dhe të stafit shëndetësor.
- ☞ Të identifikojnë dhe raportojnë rreziqet e mundshme të infeksioneve nozokomiale.

INF 184 Metodologjia e Kërkimit Shkencor (3 ETC)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Lënda është ngritur me një qasje pragmatike për të ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësi të reja në përgatitje të kërkimeve shkencore dhe në shkrimin e artikujve shkencor. Kjo është një lëndë bazë për personelin shëndetsor sepse do e fusi në "sekretet" e organizimit dhe shkrimit të saktë të një kërkimi shkencor duke marrë gjithnjë vendime të cilat jenë "evidence-based". Kjo lëndë përpiqet për të mbuluar tre komponentë kryesore të një procesi kërkimor: zhvillimi i propozimit kërkimor, puna në terren (mbledhja e të dhënave) dhe shkrimi i punës shkencor. Lënda si ashtu do i ndihmoj studentët që të zgjedhin revistat më të përshtatshme sipas temës së kërkimit.

Objektivat e modullit:

Në këtë lëndë studentët do fitojnë aftësi për të kryer si kërkime kualitative ashtu dhe kuantitative. Një objektiv kryesor është mënyra e saktë e kërkimit të literaturës si dhe formulimi i sakt i qëllimit dhe objektivave të kërkimit. Mbajtja e një qëndrim kritik ndaj kërkimeve shkencore është një objektiv kryesor e kësaj lënde.

INF 230 Bazat e Farmakologjisë (5ETC)

Ky modul ofron njohuri bazë për medikamentet. Ndahet në 2 pjesë: 1-Farmakologjia e përgjithshme ku studiohet dozimi i barnave, farmakokinetika, farmakodinamika, efektet e padëshiruara dhe rregullat e përdorimit të barnave në përgjithësi, dhe 2- Farmakologjia speciale ku për çdo grup medikamentesh sipas klasifikimit të OBSH, studiohen: perfaqësuesit, farmakokinetika, efektet farmakologjike, indikacionet, kunderindikacionet, efektet e padëshiruara dhe kujdesi infermior.

Objektivat e modullit:

Perfitimi i njohurive bazë mbi menyrat e studimit, prodhimit dhe përdorimit të barnave. Perfitimi i njohurive specifike për çdo grup barnash sipas klasifikimit të OBSH.

Aftësimi i studentëve për kujdesin infermior gjatë aplikimit të terapive të ndryshme.

INF 231 Mikrobiologji (ETC 4)

Mikrobiologjia bën pjesë në lëndët paraklinike dhe ndihmon studentin të marrë njohuri bazë për viruset, bakteret, kerpudhat dhe parazitët. Nëpërmjet mikrobiologjisë studenti merr njohuri për keto mikroorganizma që invadojnë trupin e njeriut dhe e ndihmon për të kuptuar më mirë patologjitë infektive.

Objektivat e lëndës:

Në përfundim të këtij kursi studentët do të kenë njohuri në drejtim të

- ☞ Njohja me mikroorganizmat (bakteret, viruset etj) që bien në kontakt me trupin e njeriut, infeksionet dhe shkaktarët mikrobialë të tij.
- ☞ Identifikimin e rreziqeve të mundshme shëndetësore për komunitetin ose monitorimin e tyre

INF 250 Parime bazë të menaxhimit shëndetësor (3 ETC)

Ky kurs trajton konceptet bazë, metodat dhe instrumentet e menaxhimit mjekësor. Janë dhënë njohuri bazë për drejtimin dhe organizimin e zhvillimit të projekteve shëndetësore, mbi evidentimin e aktivitetit infermior dhe ndërhyrjen për përmirësimin e ndikimit të personelit infermior. Studentët pajisen me njohuritë e nevojshme për të kuptuar mekanizmin financiar mbi të cilin funksionon veprimtaria spitalore dhe shërbimi mjekësor në përgjithësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Studentët që do të ndjekin këtë kurs do të kenë kualifikimin e mjaftueshëm për të kryer detyrën e kryeinfermiereve të pavijoneve të ndryshme.

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me strategjitë e menaxhimit shëndetësor.
- ☞ Njohja me parimet e ekonomisë së shëndetit.
- ☞ Njohja me funksionet dhe rolet e menaxhimit shëndetësor.

INF 251 Parime dhe metoda të mësimdhënies (2 ETC)

Parimet dhe metodat e reja të mesimdhënies mbështeten në Bazat e pedagogjisë dhe trajtimin bashkëkohor të koncepteve të reja pedagogjike. Metodatat e reja teknologjike dhe roli i tyre në pedagogjinë e sotme. Nëpërmjet punës individuale studimore do të sygjerojmë modele alternative në formë të punimeve të shkruara (esse). Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: Faktorët që ndikojnë në procesin e mësimdhënies, klasifikimi i modeleve sipas zhvillimit biheviorist, kognitiv dhe socioal, konceptet e mësimdhënies për të kuptuarit, zhvillimi i shprehjeve të menduarit dhe shprehjeve të shoqërisë së dijes.

Objektivat e modulit:

Kursi synon t'i pajisë studentët pasuniversitarë me qasjet bashkëkohore të programimit dhe të planifikimit të mësimdhënies si dhe t'u zhvillojë aftësitë për të hartuar dokumentacionin përkatës dhe për të shprehur qëndrim profesional. Në përfundim të këtij kursi studenti duhet:

- ☞ të zotërojë qasjet kryesore për programimin dhe planifikimin e mësimdhënies;
- ☞ të jetë i aftë të orientohej në çështjet e programimit dhe të planifikimit të mësimdhënies;
- ☞ të zotërojë aftësinë për të përzgjedhur modele për planifikimin e mësimdhënies;
- ☞ të demonstrojë qëndrimin e duhur profesional për çështje konkrete të programimit dhe të planifikimit të mësimdhënies.

INF 252 Shkrim akademik (2 ETC)

Lënda ofron një hyrje në shkrimin akademik, me një fokus të veçantë në shkrimin në shkencat e shëndetit. I pajis studentët me aftësitë e nevojshme për të strukturuar punimet akademike, për të zhvilluar argumente të qarta dhe për të integruar kërkimin e bazuar në prova. Kursi mbulon aspektet themelore të shkrimit akademik, duke përfshirë leximin kritik, rishikimin e literaturës, stilet e citimeve dhe konsideratat etike në komunikimin shkencor. Theksi vihet në qartësinë, koherencën dhe saktësinë në shkrimet shkencore dhe mjekësore. Studentët do të eksplorojnë zhanre të ndryshme të shkrimit, të tilla si punime kërkimore, rishikime të literaturës dhe shqyrtim të rasteve studimore. Kursi trajton gjithashtu rëndësinë e shmangies së plagjiaturës dhe referencës së duhur duke përdorur stilet e citimit APA, Vancouver etj. Gjatë gjithë semestrit, studentët do të angazhohen në proceset të kontrollit apo peer review për të përmirësuar aftësitë e tyre të shkruarit. Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të arsytimit logjik dhe aftësisë për të sintetizuar informacion kompleks mjekësor. Kursi përfshin detyra praktike, ushtrime në klasë dhe diskutime mbi sfidat e shkruarit në shkencat shëndetësore. Deri në fund të kursit, studentët do të jenë në gjendje të prodhojnë dokumente akademike të strukturuar mirë, të bazuara në dëshmi, të dhëna të llojeve të ndryshme, të rëndësishme për fushën e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Objektivat e modilit:

Studentet të jenë të aftë të:

- ☞ shkruajnë tekste akademike të qarta, të strukturuar dhe të mirëorganizuar që lidhen me shkencat e shëndetit.
- ☞ kryejnë kërkime efektive në literaturë dhe analizojnë në mënyrë kritike burimet për punimet e tyre akademike.
- ☞ zbatojnë stilet e sakta të citimit (APA, Vancouver etj) dhe të integronjnë referencat siç duhet për të mbështetur argumentet.
- ☞ njohin dhe shmangin plagjiaturën duke përdorur teknika të përshtatshme parafrazimi dhe referimi.
- ☞ zhvillojnë argumente të bazuara në kërkime dhe të komunikojnë gjetjet në mënyrë efektive në lloje të ndryshme të shkrimeve akademike.

INF 253 Aspekte sociale të infermierisë (2 ETC)

Në këtë lende, ne eksplorojmë kontekstin social të infermierisë profesionale dhe identifikojmë ndikimet kryesore që ndikojnë në infermierinë në shoqërinë e sotme. Kjo për një kuptim më të thellë të infermierisë na sfidon të identifikojmë përgjegjësitë tona individuale në edukimin e pacientëve tanë dhe komunitetit rreth infermierisë profesionale, si dhe përmbushjen e detyrimeve tona profesionale ndaj komunitetit. Një syllabus për Sociologjinë në Infermieri zakonisht përqendrohet në studimin e aspekteve sociale që ndikojnë në shëndetin, kujdesin shëndetësor dhe profesionin e infermierisë. Kjo lëndë është e rëndësishme për infermierët pasi ndihmon ata të kuptojnë ndikimin e faktorëve socialë në shëndetin e pacientëve dhe të krijojnë marrëdhënie efektive me ta.

Objektivat e modilit:

- ☞ të kuptojnë konceptet sociale;
- ☞ të përshkruajë mënyrat e ndryshme në të cilat individët lidhen me njëri-tjetrin;
- ☞ identifikojnë dallimet në koncepte; dhe
- ☞ të shpjegojnë mënyrat se si këto koncepte përdoren në punën sociale dhe infermieri.

INF 254 Psikologji bazë dhe klinike (2 ETC)

Gjatë këtij moduli studentët do të njihen me psikologjinë klinike. *Psikologjia klinike është nëndegë e psikologjisë një disiplinë që përfshin vlerësimin dhe trajtimin e sëmundjeve mendore, sjelljeve jonormale dhe problemeve psikiatrike.* Gjithashtu në lenden e psikologjisë klinike do të studjohet edhe sistemi DSM-V (Manuali Diagnostikues dhe Statistikor i Çrregullimeve Mendore i cili është klasifikimi i psikopatologjisë i zhvilluar nën autoritetin e Shoqatës Psikiatrike Amerikane (APA). Do të vijohet me elementet e psikopatologjisë së përgjithshme, me intervistën klinike dhe vlerësimin klinik. Qëllimi është që studentet të ketë mundësi të përvetësojnë sa më mirë kompleksin e njohurive të avancuara të praktikave psikologjike kryesore në lidhje me kuadrin e psikologjisë klinike, duke i kushtuar një vend të vecantë edhe lidhjes me vlerësimin klinik dhe psikoterapië.

Objektivat e modilit:

Në përfundim të këtij moduli studentët do të kenë njohuri në drejtim të

- ☞ Njohja me psikologjinë klinike si nëndegë e psikologjisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

- ☞ Njohja me diagnostikimin dhe klasifikimin e çrregullimeve mendore sipas DSM-5 (Manuali Diagnostik I Psikiatërve Amerikan) .
- ☞ Njohja me vlerësimin në psikologjinë klinike
- ☞ Njohja me fushat e matjes (testet psikologjike)
- ☞ Njohja me ndërhyrjet në psikologjinë klinike, format e ndryshme të psikoterapisë
- ☞ Njohja me trajtimin e çrregullimeve mendore në psikologjinë klinike
- ☞ Do të mund të realizojnë kujdesje infermiore duke pasur parasysh elementët psikologjikë në sjelljen e pacientëve.
- ☞ Do të dinë të realizojnë përkujdesjet infermiore duke u bazuar në karakteristikat e rastit.

INF 255 Shëndet profesional dhe siguria në punë (2 ETC)

Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë të profesionistëve të shëndetit.

Në këtë modul trajtohen aspekte si shëndeti në punë, siguria në punë dhe faktorët e rrezikut, dëmtimet që rrjedhin nga puna, aspektin ligjor të sigurisë dhe shëndetit në punë, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve okupacionale.

Objektivat e modulit:

- ☞ Njohja me konceptet bazë në lidhje me shëndetin në punë
- ☞ Njohja me konceptet bazë në lidhje me sigurinë në punë
- ☞ Njohja me faktorët e rrezikut në punë
- ☞ Njohja me dëmtimet që rrjedhin nga puna,
- ☞ Njohja me aspektin ligjor të sigurisë dhe shëndetit në punë
- ☞ Njohja me parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve okupacionale.

INF 110 Terminologji mjekësore (3 ETC)

Terminologjia mjekësore është një lëndë në të cilën studentët marrin njohuri mbi termat më të përdorshme latine dhe greke, fjalëformimi në këto gjuhë, morfologji, formim i recetës si dhe përdorimi i tyre klinik. Të kuptojnë e të përdorin shprehje të jetës së përditshme si dhe të jenë të aftë të përkthejnë materiale të shkencës mjekësore. Në këtë modul futen dhe seminarët të cilat synojnë të diskutojnë dhe kontrollojnë njohuritë që studentët marrin gjatë leksioneve.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të këtij kursi studentët do të kenë njohuri në drejtim të

- ☞ Njohjes me terminologjinë mjekësore, latine dhe greke.
- ☞ Njohjes me pjesët e ligjëratës në gjuhën latine.
- ☞ Njohjes me fjalë të fjalorit anatomik dhe shëndetësor.
- ☞ Njohjes me recetën mjekësore dhe rëndësinë e saj.

ENGI 130 Anglisht (3 ETC)

Qëllimi i këtij kursi është të pajisë studentët me njohuri të nivelit të avancuar terminologjik infermjerik në gjuhën angleze që përdoret në sistemin shëndetësor, në komunikimin ambulator dhe spitalor. Ky



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

program është hartuar me kërkesa më të thelluara të terminologjisë infermierike dhe mjekësore. Ai synon të ndihmojë studentët e infermierisë, të përmirësojnë aftësitë e tyre në gjuhën angleze si të lexuarit, të shprehurit, të shkruarit etj. Çështjet dhe kapitujt që trajtohen kanë të bëjnë me strukturat e ekipit spitalor, shërbimet shëndetsore, medikamentet, aksidentet dhe emergjencat, moshat dhe sëmundjet që shoqërojnë moshat e treta, ushqimet dhe vlerat e tyre ushqyese. Leksionet e trajtuara do të ndihmojnë edhe studentët që të njohin më shumë terminologjinë infermierike në anglishten profesionale në formën e saj të folur dhe të shkruar.

Objektivat e modulit:

- ☞ Të pasurojë fjalorin në terminologjinë specifike mjekësore si dhe të ndërtojë një strategji të komunikimit interpersonal në Anglisht, të pasurohen me terminologjinë mjekësore dhe farmaceutike sidoms sot në globalizimin e tregjeve të punësimit .
- ☞ Të aftësojë studentët në Listening, Speaking, Reading & Writing me qëllim që të formojë një folës të gjuhës Angleze të kompletuar dhe të aftë për të komunikuar me terminologjinë mjekësore në situata të natyrshme.
- ☞ Të aftësojë studentët të zhvillojnë më tej arritjet e tyre gjuhësore në njohjen e terminologjisë bazë specifike mjekësore dhe të zbatojnë në mënyrë krijuese kërkesat dhe veçoritë specifike në përvetësimin e terminologjisë infermieristike në vecanti.

ENGI 131 Anglisht profesionale (3 ETC)

Qëllimi i këtij kursi është të pajisë studentët me njohuri të nivelit të avancuar terminologjik infermierik në gjuhën angleze që përdoret në sistemin shëndetsor, në komunikimin ambulator dhe spitalor. Çështjet dhe kapitujt që trajtohen kanë të bëjnë me strukturat e ekipit spitalor, shërbimet shëndetsore, medikamentet, aksidentet dhe emergjencat, moshat dhe sëmundjet që shoqërojnë moshat e treta, ushqimet dhe vlerat e tyre ushqyese. Leksionet e trajtuara do të ndihmojnë edhe studentët që të njohin më shumë terminologjinë infermierike në anglishten profesionale në formën e saj të folur dhe të shkruar

Objektivat e modulit:

- ☞ Të pasurojë fjalorin në terminologjinë specifike mjekësore si dhe të ndërtojë një strategji të komunikimit interpersonal në Anglisht, të pasurohen me terminologjinë mjekësore dhe farmaceutike sidoms sot në globalizimin e tregjeve të punësimit .
- ☞ Të aftësojë studentët në Listening, Speaking, Reading & Writing me qëllim që të formojë një folës të gjuhës Angleze të kompletuar dhe të aftë për të komunikuar me terminologjinë mjekësore në situata të natyrshme.
- ☞ Të aftësojë studentët të zhvillojnë më tej arritjet e tyre gjuhësore në njohjen e terminologjisë bazë specifike mjekësore dhe të zbatojnë në mënyrë krijuese kërkesat dhe veçoritë specifike në përvetësimin e terminologjisë infermieristike në vecanti.

GERI 130 Gjermanisht (3 ETC)

Ky kurs i nivelit fillestar synon të ndihmojë studentët të përdorin gjuhën gjermane saktë e rrjedhshëm, përmes aktiviteteve të shumta e të larmishme në të cilat do të përfshihen studentët, do të mundësojnë ushtrimin, përvetësimin, zhvillimin sistematik të tri koncepteve bazë: konceptet gjuhësore, konceptet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

komunikative si edhe ato kulturore. Ushtrimet leksikore synojnë të pasurojnë fjalorin në fusha të ndryshme të jetës dhe të përdorin shprehje të jetës së përditshme si: në familje, punë, shoqëri etj. Aspektet gramatikore janë të organizuara në mënyrë të tillë që të prezantojnë çështje të reja dhe në të njëjtën kohë të përsërisin informacionet e marra në nivelet e mëparshme. Materiali teorik përforcohet me anë të ushtrimeve gramatikore në një mënyrë praktike e të dobishme të shoqëruara me situata reale në të cilat ushtrohen aftësitë komunikative. Gjithashtu zhvillohet edhe koncepti kulturor, pasi jepen sistematikisht në çdo mësim informacione kulturore rreth jetës, mendësisë e kulturës gjermane.

Objektivat e modullit:

- ☞ Të zhvillojë të katër aftësitë gjuhësore – të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit në gjuhën e huaj.
- ☞ Të zgjerojë njohuritë e studentit në lidhje me vendet gjermanishtfolëse, kulturën dhe sistemin e tyre shëndetësor.

GERI 131 Gjermanisht profesionale (3 ETC)

Kursi i Gjuhës Gjermane për Qellime të Posacme në vazhdimësi të GERI 131 synon të ndihmojë më tej studentët të përdorin gjuhën gjermane saktë e rrjedhshëm vecanërisht në fushën e infermierisë e të kujdesit shëndetësor e të njihen me sistemin shëndetësor në vendet gjermanishtfolëse. Aktivitetet e shumta e të larmishme në të cilat do të përfshihen studentët, do të mundësojnë ushtrimin, përvetësimin, zhvillimin sistematik të katër aftësive gjuhësore; të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit e të shkruarit. Ushtrimet leksikore synojnë të pasurojnë fjalorin në fusha të ndryshme të jetës e vecanërisht në fushën e infermierisë e të kujdesit shëndetësor, në mënyrë që të kuptojnë tekste të thjeshta që përmbajnë gjuhë profesionale mbi kujdesin shëndetësor, të arrijnë të marrin pjesë në një bashkëbisedim të praktikës së përditshme infermirore e të shkruajnë një raport të shkurtër në kontekst profesional të kujdesit shëndetësor. Aspektet gramatikore janë të organizuara në mënyrë të tillë që të prezantojnë çështje të reja dhe në të njëjtën kohë të përsërisin informacionet e marra në nivelet e mëparshme. Materiali teorik përforcohet me anë të ushtrimeve gramatikore në një mënyrë praktike e të dobishme.

Objektivat e modullit:

- ☞ Të zhvillojë aftësitë gjuhësore – të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit në gjuhën e huaj.
- ☞ Të zhvillojë aftësitë komunikuese.
- ☞ Të zgjerojë njohuritë e studentit në lidhje me vendet gjermanishtfolëse, kulturën dhe historinë e tyre, e vecanërisht me sistemin shëndetësor e atë spitalor në Gjermani.

ITAI 130 Italisht (3 ETC)

Ky është një kurs i mësimdhënies italiane i nivelit fillestar sipas kuadrit evropian të gjuhëve të huaja. Është një kurs didaktiv i ekuilibruar, shumë i thjeshtë dhe shumë rezultativ pasi bazohet në gjuhën moderne dhe atë teknike të përqëndruara në kompetencat e komunikimit me mjekët, infermierët dhe pacientët në sektorin shëndetësor nëpërmjet përdorimit të terminologjisë së sektorit, mënyrave të shprehjes specifike qoftë në komunikimin me shkrim qoftë në komunikimin verbal.

Objektivat e modullit:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të lexojnë, të kuptojnë dhe të shkruajnë tekste në gjuhën italiane në një kontekst të gjerë mjekësor.
- ☞ Të zhvillojnë shkathtësitë e shkrimit të tilla si të mësuarit se si të shkruajnë tekste të sakta italiane duke i kushtuar vëmendje stilit, regjistrimit, koherencës dhe korrektesisë gramatikore.
- ☞ Të praktikojnë fjalorin formal dhe mjekësor në gjuhën italiane.
- ☞ Të përdorin në mënyrë të mjaftueshme terminologji të ndryshme mjekësore në sektorin e shëndetësisë.

ITAI 131 Italisht profesionale (3 ECTS)

Kursi është ndërtuar për studentët e infermierisë së përgjithshme. Përveç një interesi të përgjithshëm për gjuhën dhe kulturën italiane, studentët e infermierisë kanë disa nevoja specifike të lidhura me përgatitjen e tyre profesionale gjuhësore dhe komunikuese në gjuhën italiane specifike të mjeksisë. Një nga qëllimet kryesore të këtij kursi është përvetësimi sa më i gjithanshëm i njohurive në gjuhën italiane të fushës së shëndetit si edhe aftësimi i studentëve për të folur dhe shkruar në mënyrë të qartë dhe bindëse. Kursi ka në fokus terminologjinë mjekësore dhe fjalorin pak më të specializuar; tekste audio mjekësore etj. Kursi përmban një seksion hyrës, me imazhe që lehtësojnë të kuptuarit; seksione të dedikuara për aftësitë individuale; ide gramatikore, lojëra dhe lojëra me role. Njësitë terminologjike përfshijnë gjithashtu: prezantimi i anatomisë së organeve; rastet klinike; materiale plotësuese në internet etj.

Kursi zhvillohet në leksione e seminare ku secili prej tyre ka për objekt:

- ☞ Të inkurajojë studentët për të analizuar në mënyrë të detajuar tekstet e fushës së shëndetit duke ndërtuar strategji të komunikimit në gjuhën italiane të mjeksisë.
- ☞ Të ndihmojë studentët të mund të zhvillojnë më tej arritjet e tyre gjuhësore e komunikative në përvetësimin e terminologjisë mjekësore.
- ☞ Të realizojë zhvillimin e ndërgjegjësimit ndërkulturor real që i mundëson studentët të kuptojnë referenca të thjeshta për aspektet e përbashkëta të kulturës italiane dhe, veçanërisht, për çështjet ndërkulturore të lidhura me mjedisin mjeko-spitalor italian.
- ☞ Të ndihmojë studentët të zhvillojnë të kuptuarit dhe të shprehurit rreth strukturave menaxhuese të fushës së mjeksisë.

INF 178 Statistikë mjekësore (3 ECTS)

Biostatistika luan një rol thelbësor në të gjitha fazat e një projekti sasior të kërkimit të kujdesit shëndetësor nga dizanjimi deri tek analiza dhe interpretimi i të dhënave. Ky modul mbulon parimet esenciale dhe metodat e kërkuara për përgatitjen dhe analizën e të dhënave. Theksi është në hartimin e studimit, analizën e duhur dhe interpretimin e rezultateve. Këtu përfshihen konceptet themelore të analizës statistikore, si dhe teknikat themelore dhe disa analiza më të avancuara. Sesionet përfshijnë leksionet dhe punën praktike, të bazuar në kompjuter (duke përdorur SPSS) dhe duke përdorur seminare të vogla për diskutim. Qëllimi i këtij kursi/lënde është që t'u mundësojë studentëve të përdorin metoda të sakta statistikore me rëndësi të veçantë për kujdesin shëndetësor të bazuar në evidenca dhe të këshillojë profesionistët e shëndetit për zbatimin e këtyre metodave dhe interpretimin e rezultateve.

Objektivat e modulit:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Lënda synon t'u mësojë kërkuesve të kujdesit shëndetësor elementet thelbësore të metodologjisë kërkimore dhe statistikave. Fokusi është kryesisht në interpretimin dhe kuptimin e metodologjisë së duhur.

CSI 130 TIK dhe Digjitalizim (3 ETC)

Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit (TIK) ka luajtur një rol kyç në procesin e digitalizimit, duke transformuar mënyrën se si funksionojnë bizneset, qeveritë dhe shoqëria në përgjithësi. Digitalizimi nënkupton përdorimin e teknologjisë për të kaluar nga proceset manuale ose analoge në ato dixhitale, duke rritur efikasitetin, transparencën dhe inovacionin.

Objektivat e modulit:

- ☞ Automatizimi i proceseve – Përdorimi i softuerëve dhe inteligjencës artificiale për të zvogëluar punën manuale.
- ☞ Transformimi i bizneseve – Kalimi nga tregtia tradicionale në tregtinë elektronike (e-commerce).
- ☞ Shërbime publike më efikase – Implementimi i e-qeverisjes për një administratë më të shpejtë dhe transparente.
- ☞ Arsimit i avancuar – Përdorimi i platformave online për mësimdhënie dhe trajnime.
- ☞ Rrjetet e komunikimit – Interneti dhe pajisjet e zgjuara që mundësojnë lidhje të vazhdueshme globale.

INF 300 – Praktika profesionale (10 ECTS)

Praktika profesionale është guri i themelit në formimin e infermierit të përgjithshëm. Ajo u jep mundësinë studentëve që ndjekin këtë program studimi të aplikojnë dhe përfeksionojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e fituara paraprakisht gjatë tre viteve akademike të këtij programi mësimor. Duke punuar së bashku me profesionistë të fushës së infermierisë, studentët do të fitojnë vet-besimin e duhur për të punuar në mënyrë të pavarur.

Objektivat e modulit:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- ☞ Të aplikojnë dhe kryejnë kujdesje infermiore të mënyrë të pavarur.
- ☞ Të njohin bazën e materialeve që i nevojitet infermierit
- ☞ Të përdorin mendimin kritik gjatë kujdesjeve shëndetsore.

INF 399 – Diploma (provim / temë) në Bsc Infermieri e Përgjithshme (6 ECTS)

Formimi i studentit në programin mësimor Bsc. Infermieri e Përgjithshme mbyllet me provim formues ose me prezantimin e një punimi shkencor nën udhëheqjen e një pedagogu. Për realizimin e këtij punimi shkencor studenti do të marrë të dhënat nga shërbimi parësor dhe dytësor, në të cilat do të kryejë praktikën profesionale.

Tematika e punimeve shkencore do të përzgjidhet nga aspektet e ndryshme të punës së infermierit.

Formimi formues do të përfshijë njohuritë e fituara të studentëve në lëndët e ndjekura në këtë program mësimor.

Neni 7

Kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Me vendim të Këshillit të Fakultetit të Shëndetit – UV duke nisur nga viti akademik 2011-2012 e në vazhdim kreditet penguese për marrjen e moduleve të programit Bcs në Infermieri të përgjithshme do të jenë si më poshtë:

Studenti që ndjek programin mësimor Bcs në Infermieri të Përgjithshme

- mund të rregjistrohet në lëndët me kode INF 2.. vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht 30 ECTS në këtë program studimi.
- mund të rregjistrohet në lëndët me kode INF 3.. vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht 60 ECTS në këtë program studimi.

Neni 8

Kurrikulat e ofruara studentëve.

Kurrikulat e moduleve të ofruara për studentët nga Departamenti i Infermierisë janë paraqitur në syllabysët përkatëse të çdo lënde, dhe shpallen në fillim të çdo viti akademik dhe semestrit nga pedagogu përkatës.

Programi i plotë i kurrikulave mësimore të ofruara për studentët e Departamentit të Infermierisë për programin Bcs në Infermieri të Përgjithshme mund të tërhiqet tek Sekretaria Mësimore e Departamentit, pas pagesës përkatëse.

Neni 9

Format dhe organizimi i studimit të programit Bcs në Infermieri të Përgjithshme

Në programin mësimor Bcs në Infermieri të Përgjithshme veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në:

- mësim në auditor (leksione, ushtrime, seminare, laboratore),
- studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektsh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj)
- veprimtari të tjera (praktika mësimore dhe profesionale). (VKM Nr.41, dt.24.01.2018, pika 2.4)

Leksionet, seminarët dhe laboratorët zhvillohen në ambientet e Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë, Fakulteti i Shëndetit, godina "D" "B" dhe "C".

Praktikat mësimore dhe profesionale zhvillohen në institucionet shëndetësore parësore dhe dytësore nën drejtimin e pedagogut të caktuar. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, punonjësi mësimor që e drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet.

Grupet mësimore të këtij programi organizohen si më poshtë: (VKM Nr.41, dt.24.01.2018, Tabela Nr.2)

Grup mësimor për leksione:	25-100 studentë.
Grup mësimor për seminare,	25 studentë.
Grup mësimor për laboratore	10 - 20 studentë.
Grup mësimor për praktika mësimore / profesionale	20 studentë.

Neni 10

Format e provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët.

Programi mësimor Bcs në Infermieri të përgjithshme parashikon në total 39 vlerësime përfundimtare të dijeve, duke përfshirë vlerësimet përfundimtare të lëndëve mësimore, të praktikës profesionale dhe tezës së diplomës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Për modulet e koordinuara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, provimet e kursit, provimet e formimit, provimet praktike (prezantime të procedurave të ndryshme në mulazhe apo pacientë realë), temat e diplomave.

Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

- a) me shkrim,
- b) me gojë,
- c) i kombinuar, me shkrim e me gojë

duke u mbështetur në programin mësimor. Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet minimalisht me një provim të pjesshme dhe një provim përfundimtar, plus kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën dhe që pasqyrohen në vlerësimin e vazhdueshëm.

Në përfundim të programit të studimit studentit i njehsohet Nota Mesatare e Ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Neni 11

Kushtet për tu konsideruar kalues në një lëndë

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ... , 10. Notat nga pesë e lartë janë kaluese.

Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabys, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha modulet.

Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studenti duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 12

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

1. Në bazë të rregullores së UV, kontrolli i njohurive në programet mësimore të FSH bëhet me një provim paraprak dhe një provim final/vetëm me një provim final si dhe me anë të detyrave të kursit apo skedave të vlerësimit në laboratore dhe praktika mësimore.
2. Brenda 6 ditësh nga kryerja e kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim.
3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

4. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit edhe pas sqartimeve të dhëna nga pedagogu i lëndës, paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit për apelimin e vlerësimit që ka marrë.
6. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apeli *ad hoc* për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tre ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimt.

Neni 13

Rikontrolli i dijeve të fituara

Studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet duhet tu nënshtrohen kontrolleve për verifikimin dhe vlerësimin periodik të krediteve të fituara, kontrolle këto për të garantuar mosvjetërimin e dijeve dhe përditësimin e tyre për kreditet e fituara më parë, për studentët që kanë kaluar dyfishin e kohës normale të studimeve.

Edhe studentët që u kanë zgjatur studimet më shumë se tre vjet përtej kohës normale të fitimit të diplomës për Bcs në Infermieri të Përgjithshme, para dhënies së tezës së diplomës iu kontrollohen kreditet e fituara.

Neni 14

Orari i studimit dhe provimeve

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Infermierisë. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimdhënësit e Universitetit.

Orari i përgjithshëm i Universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 2 javë para përfundimit të semestrit.

Orari bëhet nga Departamenti i Infermierisë dhe miratohet nga zëvendës-dekani i FSH dhe zëvendës-rektori akademik i UV.

Orari duhet të jetë i detajuar me sallat përkatëse dhe mund të ndryshojë vetëm me miratimin e zëvendës-rektorit akademik ose rektorit të UV.

Neni 15

Detyrimet e mundshme, që lidhen me frekuentimin.

- Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 70%.
- Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%.
- Frekuentimi i praktikave spitalore është i detyrueshëm në masën 100%.
- Frekuentimi i laboratoreve është i detyrueshëm në masën 100%.

Nëse, për arsye objektive, do të ketë mungesa në orë të veçanta laboratorike dhe praktike, do të gjendet koha e përshtatshme për zëvendësimin e tyre.

Neni 16

Organizimi i praktikës në programet e ciklit të parë të studimit

Praktikat mësimore dhe profesionale të programit të ciklit të parë të studimeve në Departamentin e Infermierisë zhvillohen në institucionet e Shërbimit Shëndetësor Parësor dhe Dytësor (në bazë të marrveshjeve paraprake me këto institucione), sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga Departamenti.

A. Organizimi i praktikave mësimore:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

1. Kohëzgjatja e praktikave mësimore për një modul, sipas planit mësimor është në varësi të krediteve të modulit.
2. Pasi është realizuar ndarja e grupit të leksionit në disa grupe praktike, Drejtuesi i departamentit u ndan grupet e praktikës pedagogëve përgjegjës. Titullari i lëndës u prezanton pedagogëve të praktikës, syllabusin e lëndës dhe objektivat e saj. Pedagogu përgjegjës për praktikën / udhëheqësi i praktikës merr nga sekretaria mësimore listën e studentëve të rregjistruar në grupin e praktikës mësimore/profesionale.
3. Detyrat e udhëheqësit të praktikës mësimore janë:
 - Organizon punën e studentëve në institucionin shëndetësor në bashkëpunim me personelin infermior.
 - Kontrollon ndjekjen korrekte të praktikës mësimore prej studentëve të kursit.
 - Realizon mësimdhënie klinike: diskuton me studentët rastet e paraqitura në pavion, pyet studentët për aspektet teorike të diagnostikës dhe terapisë (të trajtuara paraprakisht në leksione).
 - Ndjek angazhimin/integrimin e studentëve në kryerjen e procedurave infermiore në pavion.
 - Organizon punën e pavarur të studentëve mbi bazën e detyrave të kursit apo projekteve klinike të përbashkëta.
 - Dorëzon në fund të çdo jave mësimore mungesat e studentëve në praktikat përkatëse.
 - Vlerëson performancën e studentit në praktikën mësimore nëpërmjet një skede vlerësimi, të cilën e dorëzon në fund të semestrit përkatës në sekretarinë mësimore.
 - Përpara paraprovimit të pjesshëm dhe provimit final, dorëzon tek lektori i lëndës dhe sekretaria mësimore, listën e studentëve me frekuentimin e orëve mësimore dhe studentët të cilët nuk futen në provim për arsye mungesash.
 - Përpara provimit final udhëheqësi i praktikës mësimore dorëzon në sekretarinë mësimore dhe tek lektori i lëndës
 - Skedën e vlerësimit të performancës së studentit në praktikën mësimore (shtojca nr. 4 e rregullores së Departamentit të Infermierisë).
 - Vlerësimin vjetor të studentit (1-10%).

B. Organizimi i praktikave profesionale:

1. Kohëzgjatja e praktikave profesionale realizohet në bazë të planit mësimor.
2. Praktika profesionale, që realizohet prej studentëve të ciklit të parë të studimeve, udhëhiqet prej pedagogut të përcaktuar prej drejtuesit të departamentit dhe realizohet në institucionet e shërbimit shëndetësor dytësor.
3. Detyrat e pedagogut udhëheqës të praktikës profesionale janë:
 - Realizon shpërndarjen e studentëve në institucionin e përcaktuar nga departamenti, sipas një grafiku rotacioni të përcaktuar paraprakisht.
 - Organizon punën e studentëve në institucionin shëndetësor në bashkëpunim me personelin infermior.
 - Mbikëqyr në mënyrë periodike angazhimin dhe performancën e studentëve në procedurat infermiore, duke marrë edhe opinionin e infermiereve të pavionit.
 - Organizon dhe lehtëson punën e pavarur të studentëve mbi bazën e projekteve klinike apo temave të diplomës.
 - Vlerëson performancën e studentit në praktikën profesionale nëpërmjet një skede vlerësimi, të cilën e dorëzon në fund të semestrit përkatës.
4. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces mësimor.
5. Përpara provimit të praktikës udhëheqësi i praktikës profesionale dorëzon në sekretarinë mësimore:
 - Raportin e frekuentimit të praktikës profesionale nga studentët (rregjistri akademik).
 - Skedën e vlerësimit të performancës së studentit në praktikën profesionale (shtojca nr. 4 e rregullores).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Neni 17

Karakteristikat e Detyrave/Projekteve të kursit

Detyrat dhe projektet e kursit në programin Bcs në Infermieri të Përgjithshme janë dy tipesh: Raportime rasti dhe Studime kros-seksionale (individuale apo në grup). Kërkesat për secilin tip paraqiten më poshtë:

RAPORTIMI I RASTIT

Gjeneralitetet – emri, mbiemri, mosha, venbanimi

Epidemiologjia (përhapja) e sëmundjes – ku haset me shpesh: në ç'vënd dhe në ç'periudhë të vitit.

Etiologjia (shkaktarët) e sëmundjes – cili ka qenë shkaku i sëmundjes së pacientit që po raportohet. Veç kësaj do të përmenden edhe shkaktarët e tjerë të kësaj sëmundjeje sipas literaturës.

Klinika e sëmundjes:

- Gjithë paraqitja klinike e sëmundjes në momentin e raportimit
- Ecuria klinike që nga momenti i fillimit të sëmundjes (anamnezis morbi)
Gjatë paraqitjes klinike të sëmundjes do të evidentohen tiparet klinike karakteristike të sëmundjes që paraqet pacienti, së bashku me shenja të tjera klinike që nuk janë tipike apo nuk janë pjesë e kësaj sëmundjeje.
- Paraqiten gjithë problemet e tjera shëndetsore apo të stilit të jetesës që ka pacienti, si dhe mënyrat e mundshme sesi ato mund të kenë ndikuar në klinikën apo trajtimin e sëmundjes bazë (anamnesis vitae)
- Pas kësaj, duke iu referuar literaturës, do të paraqitet spektri i plotë i tipareve klinike dhe komplikacioneve të sëmundjes në fjalë.

Diagnostikimi:

- Do të paraqitet diagnoza klinike e vendosur nga mjeku përkatës dhe do të argumentohen arsyet pse është vendosur kjo diagnozë.
- Do të renditen ekzaminimet që ka kryer pacienti dhe do të referohen nga literatura të gjitha ekzaminimet e mundshme, duke nënvizuar ekzaminimin kyç në vendosjen e diagnozës së kësaj sëmundjeje.

Trajtimi:

- Do të paraqitet ecuria e trajtimit që nga fillimi i sëmundjes, çfarë është ndryshuar në këtë plan trajtimi apo plan asistence dhe pse.
- Do të paraqitet trajtimi aktual i të sëmurit, duke argumentuar arsyet pse është vendosur në këtë plan asistence në momentin aktual të zhvillimit të sëmundjes.
- Do të referohen nga literatura planet e tjera të mundshme të asistencës së të sëmurit. Do të krahasohen ato me planin aktual të asistencës të pacientit.
- Do të jepen rekomandimet e mundshme për përmirësimin e planit aktual të asistencës së pacientit.

Proгноza (parashikimi mbi ecurinë e sëmundjes):

- Do të referohet prognoza e pacientit sipas mjekut që e ndjek.
- Do të bëhet një parashikim sipas mendimit personal të referuesit.

STUDIMET CROS-SEKSIONALE

Hyrja – bëhet një parashkrim i shkurtër i përmbajtjes së punimit, duke theksuar çfarë sjell të re ky studim, çfarë ka interesante dhe të rëndësishme që t'ia vlejë për tu lexuar.

Fjalët kyçe – emërtimet kryesore dhe më të shpeshta të punimit.

Referimi i literaturës – bëhet përmbledhja e literaturës së studiuar mbi temën e punimit. Përmenden punime të ngjashme dhe krahasohen konkluzionet. Trajtohet gjerësisht problemi nga ana teorike dhe studimore.

Referimi i literaturës së huaj bëhet me përpikmëri. Për çdo paragraf vendoset numri korrespondues me literaturën nga është marrë, që është listuar tek sektori 'Referencat'. Nuk lejohet citimi i asnjë paragrafi i pashoqëruar me referimin përkatës.

Qëllimi dhe Metoda – paraqitet çfarë qëllimi ka studimi, objektivat e përgjithshme dhe specifike, si dhe metodat dhe instrumentat e përdorur për realizimin e këtyre qëllimeve dhe objektivave. Përshtatet me hollësi e gjithë metodologjia e punës, çdo veprim i kryer, p.sh: studimi i kartelave, krahasimi i protokolleve të trajtimit, aplikimi i planeve të asistencës, plotësimi i pyetsorëve, mbledhja e të dhënave nga statistikat, shqyrtimi klinik i rasteve.

Rezultatet – paraqiten të gjitha të dhënat e mbledhura në tabela dhe në paraqitje grafike. Grafikët shoqërohen me komente sqaruese.

Diskutimi – komentohen të dhënat e mbledhura në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave.

Konkluzionet dhe Rekomandimet – bëhet një përmbledhje e rezultateve të evidentuara dhe jepen rekomandimet për përmirësim në politikat shëndetsore aktuale apo për ngritjen e politikave të reja (parandaluese, diagnostikuese, terapeutike, etj)

Referencat – çdo libër referohet me titull, emër autori, vit botimi, ISBN dhe faqet nga është marrë citimi. Nëse referimi është nga interneti, vendoset adresa e plotë e internetit. Listimi i literaturës bëhet sipas renditjes alfabetike.

- ☞ Temat do të shkruhen në formatin Times New Roman 12.
- ☞ Një kopje elektronike do të niset me e-mail
- ☞ Një kopje e shkruar do të dorëzohet pedagoges
- ☞ Punimet do të prezantohen në formatin Ms.PowerPoint gjatë dy javëve të fundit të semestrit.
- ☞ Çdo student do të prezantojë pjesën me të cilën ka punuar më shumë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Neni 18

Modalitetet për mbrojtjen e diplomës në programin Bcs në Infermieri të Përgjithshme

Mbrojtja e Diplomës në përfundim të programit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme parashikohet me provim formues ose me përgatitjen e një teze diplome.

- Mesatarja e notave për marrjen e temës së diplomës përcaktohet me vendim të SA, pas propozimeve të departamentit.
- Studentëve të programeve bachelor u llogaritet mesatarja e ponderuar në bazë të notave të marra gjatë semestrit të parë.
- Studentët të cilët gjatë semestrave paraprakë të studimeve kanë një mesatare aritmetike të lëndëve më të ulët se mesatarja e parashikuar nga SA, ose që nuk dëshërojnë të realizojnë temë diplome, do të diplomohen nëpërmjet provimit të përgjithshëm formues.

Neni 19

Mbrojtja e diplomës me provim formues të përgjithshëm

1. Studentët që nuk e arrijnë mesataren e përcaktuar me vendim SA diplomohen me provim të përgjithshëm teorik.
2. 3 muaj përpara sezonit të provimit të diplomës, departamenti përcakton lëndët e formimit karakterizues dhe me zgjedhje të programit, që do të përfshihen në provimin e përgjithshëm përfundimtar. Titullarët e lëndëve dorëzojnë në departament temat e përzgjedhura për secilën lëndë, nga të cilat do të nxirren pyetjet e provimit.
3. Lista e temave mësimore që do të pyeten në provimin e diplomës vihet në dispozicion të studentëve 2 muaj përpara sezonit të diplomës (fotokopje, afishim në ambiente të dukshme, web-i i UV, facebook-u i FSH).
4. Informimi i studentëve për formën e vlerësimit të njohurive (formën e provimit) bëhet 2 muaj përpara përfundimit të semestrit.
5. Hartimi i tezës së provimit të diplomës:
 - Banka e pyetjeve për secilën lëndë, së bashku me pikët maksimale për çdo pyetje, do të dorëzohet e firmosur prej titullarit të lëndës tek drejtuesi i departamentit, 1 javë përpara sezonit të diplomimit.
 - Pyetjet janë të formuluar përgjithësisht në formë quiz-esh dhe pyetjesh shtjelluese. Çdo pyetje duhet të shoqërohet me numrin e pikëve maksimale, që mund të merren prej saj.
 - Formulimi i tezës së provimit bëhet nga Drejtuesi i departamentit. Ai përzgjedh nga banka e pyetjeve një përqindje të caktuar të pyetjeve prej secilës lëndë, sipas vlerës specifike të krediteve që ka lënda: lëndët me më shumë kredite do të kenë edhe përqindjet më të larta të pikëve në provim. Në total shuma e pikëve maksimale të të gjitha pyetjeve të përfshira në tezën e provimit të diplomës është 100 pikë.
 - Minimalisht hartohen 6 (gjashtë) teza provimi.
6. Elementet e tezës së provimit janë:
 - Emri: Teza e provimit të diplomës në programin
 - Sezoni i diplomimit
 - Varianti i tezës
 - Numri i sekretimit
 - Drejtuesi i departamentit: emri, firma
 - Dekani i FSH: emri, firma, vula e njësisë kryesore.
 - Çdo pyetje duhet të shoqërohet me numrin e pikëve maksimale, që mund të merren prej saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

- Pyetjet e të njëjtës lëndë janë të grupuara në një faqe. Çdo fletë e tezës ka pyetje vetëm të një lënde. Teza ka aq fletë sa lëndë janë përfshirë në të (plus fletët e bardha që mund tu duhen studentëve për të zhvilluar përgjigjet).
 - Sekretimi bëhet nga drejtuesi i departamentit
7. Pas marrjes në dorëzim të procesverbalit të vlerësimit të provimeve, drejtuesi i departamentit u komunikon privatisht studentëve sasinë e pikëve të marra dhe notën përkatëse.
 8. Anëtarët e komisionit të korrigjimit të provimit bëjnë korrigjimin e tezave të sekretuara sipas lëndeve specifike.
 9. Studenti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për vlerësimin e marrë nga pedagogu që ka bërë korrigjimin.
 10. Në rast pakënaqësie studenti ndjek procedurën e apelimit të notës, si në provimet e lëndëve.
 11. Procesverbali përfundimtar i vlerësimeve në provimin e diplomës dorëzohet në sekretari nga drejtuesi i departamentit. Ai firmoset nga gjithë pedagogët që kanë marrë pjesë në korrigjimin e tezës.

Neni 20

Karakteristikat e Tezës së Diplomës

Projektet e Tezës së Diplomës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

- Të jenë studime kros-seksionale, (klinike, komunitare apo kërkime në internet),
- Të jenë studime deskriptive apo analitike.
- Jo domosdoshmërisht origjinale,
- Me udhëheqje shkencore apo krejtësisht të pavarura
- Të plotësojnë kërkesat e renditura në Nenin 16 për studimet kros-seksionale.

STRUKTURA E TEMAVE TË DIPLOMËS NË PROGRAMET BACHELOR TË INFERMIERISË

Parime të përgjithshme - Të gjitha temat duhet ti zhvilloni mbi kujdesin infermior të patologjive të ndryshme. Ju keni studiuar 3 vjet për infermieristikë dhe do ta mbronni diplomën e studimeve tuaja në fushën për të cilën keni studiuar. TEMAT QË NUK DISKUTOJNË MBI KUJDESIN INFERMIOR DO TË JENË TË PAPRANUESHME.

Temat nuk duhet ti kopjoni apo merrni të gatshme (shqip apo anglisht)!

Deri tani verifikimi i plagjiaturës është ndëshkuar me notën 4. Këtë e tutje plagjiatura në temat e diplomës (neni 82 i Rregullores së UV) do të ndëshkohet sipas masave të parashikuara në nenin 74 të Rregullores së UV deri në pezullim apo përjashtim nga fakulteti.

Titulli i temës – duhet të përshkruani një lidhje midis dy komponentëve mjekësorë, apo një specifikë të studiuar. Emrat e sëmundjeve (insuficienca kardiale, diabeti melitus) nuk janë tituj temash studimore.

Shembuj: *Ndikimi i fizioterapisë në parandalimin e dekubituseve.*

Roli i infermierit në edukimin shëndetsor të diabetikëve.

Kujdesi infermior gjatë monitorimit të hipertensivëve.

Qëllimi i temës – parashtroni arsyen kryesore përse e keni bërë këtë studim.

Shembuj: *Risiti e kujdesit infermior në shërbimin e dializës.*

Ndikimin e promocionit shëndetsor në parandalimin e komplikacioneve të diabetit.

Objektivat e temës – shprehni në mënyrë të specifikuar nënçështjet e marra në diskutim.

Shembull:

1. *Paraqitje e shkurtër e Infarkt të Miokardit.*

2. *Kujdesi infermior në infarkt miokardi.*

3. *Përvoja amerikane/europiane në kujdesin ndaj infarkt.*

4. *Shkurtimi i ditëqëndrimit në spital të pacientëve me aplikimin e protokollit të ri infermior.*

Zhvillimi i temës – Tema duhet të jetë një punë e mirëfilltë studimore, që do të thotë se ajo do të jetë rezultati i përmbledhjes së shumë librave dhe artikujve të botuar mbi subjektin e saj. Për ciklin e parë të studimeve (niveli Bcs) nuk është e detyrueshme që tema të përfshijë paraqitjen e rasteve konkrete të të sëmurëve (studime klinike). Është mëse e mjaftueshme që ajo të paraqesë vetëm një përmbledhje të mendimit teorik bashkëkohor (shqiptar dhe ndërkombëtar) mbi çështjen e zgjedhur për tu studiuar – studim literature i tipit review.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Konkluzionet – paraqisni në mënyrë të përmblëdhur të dhënat, idetë apo përfundimet më kryesore të arritura gjatë zhvillimit të temës.

Shembull: Hipertensioni arterial është sëmundje e shpeshtë e moshave të treta. Kujdesi infermior tek këta pacientë konsiston në monitorimin e TA, edukimin shëndetsor mbi stilin e jetesës, personalizimin e dietës. Edukimi shëndetsor i vazhdueshëm nga ana e infermierëve e ul ndjeshëm dozën e medikamenteve antihipertensivë.

Rekomandimet – paraqisni mendimet që ju keni për përmirësimet që duhen bërë apo për studimet e mëtejshme në fushën që keni studiuar.

Shembuj: Infermierët duhet të jenë protagonistët kryesorë në edukimin shëndetsor të pacientëve diabetikë.

Transferimet nga një repart në tjetrin duhen pasqyruar edhe në kartelën infermiore.

Duhet të zhvillohen studime klinike në aplikimin e këtij protokoll infermior.

Referencat – me shumë përgjegjësi duhet të paraqisni të gjitha burimet nga e keni marrë informacionin e përdorur për studimin tuaj (libra, revista, artikuj, faqe interneti). Renditja e paraqitjes së referimeve duhet të jetë: Autorët, Viti i botimit, Emri i librit/artikullit, Faqja nga është marrë paragrafi i cituar / Faqja e internetit nga është marrë artikulli. Numrat korrespondues të referimeve duhet ti vini në fund të çdo paragrafi/fjalie që keni përdorur gjatë zhvillimit të temës.

Shembuj:

1. Evans, G.W., & English, K. (2002). The environment of poverty: Multiple stressor exposure, psychophysiological stress, and socioemotional adjustment. *Child Development*, 73(4), 1238–1248.

www.unicef.org/tfymacedonia/MK_Pub_ELDS_ALB.pdf. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të Republikës së Maqedonisë, 2009. Standartet për mësim dhe zhvillim të hershëm të fëmijëve në moshë 0-6 vjeç.

Neni 21

Modalitetet për marrjen e diplomës në programin Bcs në Infermieri të Përgjithshme

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të parë të studimeve në programin Bcs në Infermieri të Përgjithshme në Fakultetin e Shëndetit – UV janë:

1. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplinat:
 - e formimit të përgjithshëm
 - karakterizuese
 - ndërdisiplinore, të lidhura me disiplinat karakterizuese
 - praktikën profesionale
2. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në:
 - 2 module të disiplinave me zgjedhje
 - 1 modul për njohuri të tjera formuese (gjuhë e huaj, njohuri statistikore, kompiuterike)
3. Studenti duhet të ketë vlerësim 'kalues' në tezën e diplomës, sipas kërkesave të paraqitura në Nenin 21 të Rregullores së këtij programi mësimor.
4. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar jo më pak se 180 ECTS (kredite).

Procedura e diplomimit

1. Studentët që kanë plotësuar detyrimet e një programi studimi dhe çdo detyrim tjetër financiar dhe material kundrejt universitetit pajisen me diplomë, e cila është një dokument zyrtar.
2. Përmbajtja dhe forma e Diplomës, si dhe formati i Suplementit të Diplomës është i përcaktuar nga MAS në udhëzimin përkatës.
3. Modalitetet e prodhimit dhe shpërndarjes së diplomave përcaktohen në Rregulloren dhe Statutin e UV.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

4. Studenti paraqet në Sekretarinë e Departamentit të Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit, kërkesën për diplomim, së bashku me gjeneralitetet personale.
5. Në bazë të kërkesës së studentit merret një kopje e listës së notave të studentit nga sekretaria mësimore.
6. Komisioni i Verifikimit të Diplomave verifikon plotësimin e kriterëve të diplomimit për Bachelor: Infermier i Përgjithshëm.
7. Nëse pas verifikimit konstatohet se studenti i ka plotësuar kriteret për tu diplomuar, Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit paraqet në Rektorat aprovimin e diplomimit të studentit në fjalë.
8. Pasi Rektori i Universitetit "Ismail Qemali"-Vlorë aprovon kërkesën për diplomim Sekretaria mësimore e Departamentit të Infermierisë plotëson Diplomën dhe suplementin e Diplomës për çdo student.
9. Diplomat e ciklit të parë shoqërohen me suplementin. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës.
10. Studenti merr formularin për marrjen e diplomës tek sekretaria mësimore e departamentit dhe paraqitet në Bankë për të bërë pagesën.
11. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari gjatë ceremonisë së diplomimit ose në zyrën e Kryesekretares së FSH, sipas Rregullores së UV (neni 64).
12. Nëse studentit i nevojitet programi i plotë mësimor, merr formularin për program tek sekretaria mësimore, bën pagesën tek Banka, dhe më pas tërheq programin e firmosur dhe të vulosur nga Rektori pranë sekretarisë së departamentit.

Neni 22

Shkeljet e rregullave të fakultetit

Shkelje të rregullave të FSH konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cënojnë personalitetin e mësimdhënies dhe të çdo punonjësi tjetër të shkollës, normat etiko-morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, aktet e rruçqerisë, të vjedhjes etj, kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale.

Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim;
- përjashtim nga shkolla për një vit;
- përjashtim nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës;
- përjashtim përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës.

Vendimin për përjashtimin e studentit një vit nga shkolla e merr Dekanati i Fakultetit të Shëndetit.

Vendimin për përjashtimin nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (heqje vetëm e së drejtës së studimit të filluar) dhe përjashtimin përgjithmonë nga Universiteti Ismail Qemali i Vlorës (duke mos i lejuar të fitojë të drejta studimi të mëpasshme) e merr Rektorati i Universitetit Ismail Qemali të Vlorës, mbi bazën e propozimit të Dekanatit.

Neni 23

Shkeljet e integritetit akademik

Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Fakultetin e Shëndetit - UV duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

1. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljeje gjatë provimeve.

2. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë studentët pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifrazimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifrazimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.

3. Mashtrim në raporte laborator duke fallsifikuar të dhëna apo duke dorëzuar të dhëna të pabazuara në punën vetjake të studentit është shkelje.

4. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

5. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterikë duke përfshirë modifikimin e skedar kompjuterikë të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laborator dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

Neni 24

Kushtet për procedurat e modalitetet për ndërprerjen e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më tepër se një vit dhe vetëm për këto raste:

- Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport nga komisioni mjeko-ligjor, ku të jenë shprehur qartë diagnoza e rekomandimi. Dokumentat duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit.
- Kur mbetet kryefamiljar, në raste fatkeqësish e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara nga zyrat e Pushtetit Lokal Këto dokumenta duhet të paraqiten përpara shkëputjes nga Universiteti të shoqëruara me një kërkesë drejtuar Rektoratit.

Studentët të cilët ndërpresin studimet për dy ose më shumë semestra rradhë, duhet të aplikojnë përsëri për pranim në Universitet. Vendimi merret nga një komision i ngritur nga Rektorati.

Neni 25

Kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve

Procedurat transferuese në Fakultetin e Shëndetit përcaktohen në rregulloren e Universitetit 'Ismael Qemali' të Vlorës. Procedurat transferuese përfundojnë përpara para fillimit të simestrit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORE"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Studentët e Fakultetit të Shëndetit - UV të cilët duan të tranferohen në universitete të tjera të vendit, në të njëjtën degë dhe sistem, paraqesin kërkesën në sekretarinë e departamentit për tërheqjen e listës së notave. Pas përgjigjes së pranimit nga universiteti pritës, përcillet dokumentacioni i plotë i studentit; detyrimet e shlyera me notat përkatëse, dëftesa e shkollës së mesme, dokumentacioni i bursës, etj. Pas kryerjes së transferimit studenti humb statusin e studentit të UV.

Për studentët që duan të transferohen në FSH, Komisioni i ekuivalentimit të moduleve dhe krediteve të programeve mësimore të FSH, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon universiteti përkatës, përcakton detyrimet që do të ketë studenti, nëse pranohet në atë degë, sipas planit mësimor në fuqi si dhe njohjen e shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë. Këto transferime bëhen sipas akteve ligjore të miratuara nga MAS.

Fakulteti i Shëndetit njeh si kredite të formimeve universitare në programin Bcs në Infermieri të Përgjithshme njohuri të veprimtarive formuese (module, praktika profesionale në shërbimin shëndetësor parësor dhe dytësor) të nivelit pas shkollës së mesme që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit, numrin e orëve mësimore dhe kurrikulën e modulit minimalisht me 80% të normave të ofruara nga programi mësimor i FSH. Numri maksimal i krediteve të njohura në këtë rast nuk i kalon 60 ECTS. (kreu II, pika 7, udhëzimi 15 i MAS)

Neni 26

Dispozita të veçanta

1. Procedurat e hollësishme të procesit të Transferimit të studimeve, Rregullorja e Praktikave mësimore dhe profesionale, Rregullorja e Provimeve dhe Rregullorja e Diplomimit janë paraqitur në Rregulloren e Departamentit të Infermierisë.
2. Këshilli i Fakultetit të Shëndetit– UV ka të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Senatin Akademik të Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë.

Drejtuese e Departamentit të Infermierisë
Dr. Denada Selfo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Studentët e Fakultetit të Shëndetit - UV të cilët duan të transferohen në universitete të tjera të vendit, në të njëjtën degë dhe sistem, paraqesin kërkesën në sekretarinë e departamentit për tërheqjen e listës së notave. Pas përgjigjes së pranimi nga universiteti pritës, përcillet dokumentacioni i plotë i studentit: detyrimet e shlyera me notat përkatëse, dëftesa e shkollës së mesme, dokumentacioni i bursës, etj. Pas kryerjes së transferimit studenti humb statusin e studentit të UV.

